Informacion mbi Special Benefit (Përfitim Special) për ato persona që mbajnë viza të përkohëshme mbrojtjeje, viza humanitare dhe viza në pritje për tu kthyer mbrapa

Information on Special Benefit for Temporary Protection—**Albanian**

Çfarë është Special Benefit?

Përfitimet e Vecanta janë pagesa për njerëzit të cilët janë me të vërtetë në vështirësi financiare personale dhe nuk kanë të drejtë për pagesa të tjera nga Centrelink. Në qoftë se ju keni vizë mbrojtëse të përkohshme ose vizë humanitare të përkohshme ose vizë që pritni të ktheheni ju **mund** të këni të drejtë për Përfitime të Pagesave të Vecanta nga Centrelink.

Çfarë duhet të bëj unë që tëmarr Special Benefit?

Ju duhet të bëni lutje për Special Benefit nëpërmjet Centrelink-ut sa më shpejt të jetë e mundur. Kur të shkoni në Centrelink ju do të intervistoheni për të parë nëse ju jeni në gjendje të merrni Special Benefit. Normalisht pagesa do t'ju bëhet 2 javë pas intervistës tuaj me Centrelink-un. Marrja e pagesave Special Benefit do të varet nga të ardhurat dhe pasuria juaj, dhe të ardhurat dhe pasuria e partnerit tuaj

Nëse jeni mbajtës i një vize për mbrojtje të përkohshme, humanitare ose strehimi të sigurtë, ose viza në pritje për tu kthyer mbrapa, mund t'ju duhet të plotësoni me sukses Special Benefit Activity Test duke kërkuar për punë të përshtatshme me pagesë dhe duke qënë të përgatitur të merrni pjesë në Employment Pathway Plan me Centerlink ose me Employment Services Provider.

Mund t'ju kërkohet të ndërmerrni Vocational Training (Treinim për Zanat), merrni pjesë në Language, Literacy &Numeracy Programs (Programet e Gjuhës, Leximit dhe Numërimit), në Voluntary Work (Punë Vullnetare) dhe/ose në Work for the Dole (punë pa pagesë për të siguruar vazhdimësinë e Përfitimit në rast Papunësie). Në rast se nuk jeni në gjendje të plotësoni Special Benefit Activity Test mund t'ju vihen dënime, të ngjashme me ato që aplikohen për klientat e Newstart (që janë duke kërkuar për të gjetur punë), mirëpo, në disa rrethana të caktuara ju mund të përjashtoheni nga Special Benefit Activity Test.

Centrelink-u do të paguajë pagesën e Special Benefitit-it direkt në llogarinë tuaj të bankës. Nëse nuk keni një llogari bankare do të ju duhet që të hapni një në cilëndo bankë që të dëshironi. Do të keni nevojë gjithashtu për Tax File Number (Numër Takse). Nëse nuk e keni këtë numër ju duhet të bëni lutje për Numrin e Taksës gjatë intervistës tuaj me Centrelink-un.

Sa shpesh do të paguhem?

Special Benefit paguhet një herë në dy javë në llogarinë tuaj të bankës.

Çfarë duhet t'i tregoj Centrelink-ut?

Nëse ju merrni Special Benefit, Centrelink do t'ju këshillojë me shkrim për ndryshimet në rrethanat tuaja, për të cilat duhet të na tregosh ne. Ju duhet t'i tregoni Centrelink menjëherë nëse ndonjëra nga të mëposhtment ndodh. Kjo bëhet për të siguruar që ju paguhet shuma që ju takon nga Special Benefit. Ndryshimet për të cilat ju duhet të na lajmëroni mund të përfshijnë:

- nëse ju gjeni punë, **ose**
- të dhënat e të ardhurave ose pasurisë tuaj kanë ndryshuar, **ose**
- ju është anolluar viza e mbrojtjes së përkohëshme, e mbrojtjes së përkohëshme humanitare ose ajo në pritje për tu kthyer mbrapa, ose ju është dhënë një vizë e re ose një vizë e ndryshme nga të mësipërmet.

Australian Government
Centrelink
giving you options
www.centrelink.gov.au

Po sikur të mos jem dakort me vendimin e Centrelink-ut?

Ju mund të kërkoni që vendimi të rishikohet. Nëqoftëse prapë nuk jeni të kënaqur, Centrelink-u do të ju spjegojë të drejtat tuaja të tjera për apelim.

Si të merrni informacione më shumë

Të flisni me Centrelink në gjuhët e tjera përvec Anglishtes, telefononi **13 1202***. Informacioni në gjuhën tuaj mund të gjindet tek faqja e internetit **www.centrelink.gov.au**

*Pagesat për telefonatat nga telefoni i shtëpisë tek numrat "13" të Centrelink variojnë sipas linjës së shërbimit telefonik që ju keni. Telefonatat tek numrat "1800" nga telefoni i shtëpisë tuaj janë falas. Telefonatat e bëra nga telefonat publik ose cellular janë me tarifa më të larta.